



EJONA HYSI

Ja doli! Krijoi markën e saj, "Shirel organic"

Ejona Hysi, një biokimiste 32-vjeçare, ka arritur të krijojë markën e saj të kozmetikës artizanale, "Shirel Organic".

Pas përfundimit të katër kurseve profesionale në kozmetikën artizanale, ajo themeloi markën e saj në vitin 2022. Ejona u trajnuar në Qendrën e Kurseve, ACE, më pas u punësua si instruktore për prodhimin e sapunëve organikë. Ajo tregon se pasionin për kozmetikën e ka trashëguar nga dyqani i nënës së saj dhe se dëshira për të prodhuar vetë produktet e saj u ndez pas kërkimeve online.

Aktualisht, ajo planifikon të hapë një dyqan dhe një punishte ku njerëzit mund të ndjekin procesin e prodhimit të sapunëve dhe qirinjve.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:





Si e tregon Ejona historinë e saj të suksesit?

E diplomuar në farmaci, kam punuar në laboratorin e shkollës. Meqenëse aty mësohej për ilaçet, doja të shtoja njohuritë e mia në lidhje me kozmetikën. Pse jo kozmetikë natyrale?!” – thotë Ejona, e cila tregon se si është rritur në dyqanin e mamasë së saj që tregtonte kozmetikë

“Pasi mbarova shkollën u lidha më shumë me prodhimin. Mendova, pse mos t’i prodhoj vetë?”

Dëshira e saj u ndez më shumë kur pas kërkimeve online gjen Qendrën e Kurseve ACE për kozmetikë artizanale.

“U regjistrova pasi pashë programet, në 3 kurse paralelisht: sapun kozmetik, prodhim i vajrave esenciale, më pas për qirinjtë.”

Në fillimet e saj ajo nuk u mjaftua me një mundësi, ndaj mori pjesë në disa kurse profesionale të kozmetikës artizanale. Në vitin 2022, Ejona u diplomua nga Qendra e Kurseve, ACE, me rezultate të shkëlqyera. Pa kaluar shumë kohë ajo krijon markën e saj “Shirel Organic” të produkteve artizanale në kozmetikën e kujdesit të lëkurës. 1 vit më pas, trajnohet në Trajnimin e Trajnerëve (TOT).

“Në fillim nisa me prodhimin e sapunëve dhe më pas shtova produktet me përzierje vajore për lëkurën”, tregon Ejona për të shtuar se rrugëtimi i saj nuk mbaroi këtu, por kalon në një nivel tjetër profesional duke dhënë mësim për prodhimin e qirinjve dhe sapunëve për dashamirës të tjerë të kozmetikës artizanale. Sipas saj, procesi i prodhimit është shumë interesant. Procesi i praktikës është shumë joshës.

“Jam gati për kurs tjetër, tani për prodhimin e parfumeve”.

Punishtja e saj ka tre vjet që është hapur dhe ka një ecuri shumë të mirë. Vendosija e një stende në fundvit ishte një sukses që kurrë nuk do e imagjinonte nëse atë ditë që gjeti kursin online të mos kishte vendosur menjëherë të regjistrohej. Hapi i radhës për të nuk është thjesht një dyqan, por një punishte e aksesueshme nga njerëzit ku ata mund të ndjekin procesin e prodhimit të sapunëve dhe qirinjve.

“Kush ka dëshirë të mësojë, do jap dhe kurse.”

Kur pyetet se sa i vlejten kurset, Ejona përgjigjet se i ndryshuan krejtësisht rrjedhën e jetës. *“Çfarë doja të bëja para, e çfarë dua tani?!”*, thotë ajo duke kujtuar se më parë ishte një “shitëse”, sot një prodhuese. Albania Craftsman Education është një qendër kursesh profesionale afatshkurta ku dominon 70% praktika dhe 30% teoria. Studentët që ndjekin kurset janë kryesisht nga mosha 18-35 vjeç. Qëllimi dhe misioni primar që qendra ka, është mbështetja e studentëve në startup-et e tyre, ku ACE ndihmon në hartimin e planeve konkrete biznesi & marketingu. Në bashkëpunim me RisiAlbania është bërë i mundur trajnimi i instruktorëve (TOT) nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtar, për ta bërë aftësimin profesional në ACE sa më të lehtë dhe me kosto të reduktuar.

